



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5356 prot.

Himarë, më 21.11.2023

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 48 datë, 21.11.2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË KRYESIVE DHE  
MIRATIMIN E KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË BASHKINË HIMARË”  
(PAS RISHQYRTIMIT)**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, dhe pika 1/1.2, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3 datë 29.01.2021 “Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki”, Vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.41,42,43,44,45 të datës 22.09.2023, shkresës nr.953/1 prot., datë 09.11.2023 me lëndë : “ Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Himarë.” si dhe nenit 16, pika 2, të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”, Këshilli Bashkiak pasi rishqyrtoi projektvendimin së bashku me dokumentacionin e plotësuar,

**VENDOSI:**

- 1-Të miratojë kryetarët e kryesive të fshatrave, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2-Shpërblimi i kryetarëve të fshatrave të jetë në masën 10% të pagës mujore të kryetarit të këshillit bashkiak, sipas nenit 9 të ligjit nr.35/2015 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike ,si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi .
- 3-Fondi për shpërblimin e kryetarëve të fshatrave të mbulohet nga buxheti i bashkisë, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë, nr.70, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2022”, të ndryshuar me vendimin nr.37, datë 07.08.2023 “Për miratimin e ndryshimeve buxhetore mbi efektin e rritjes së pagave”.
- 4 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë.

**KRYETARI**  
Dhimitër Kapa



## LISTA EMËRORE E KRYETARËVE TË FSHATRAVE TË BASHKISË HIMARË

### A.Njësia administrative Horë – Vranisht

- |  |                   |
|--|-------------------|
| 1.Fshati Kuç Qendër Kryetari i kryesisë së fshatit | Z.Astrit Balilaj  |
| 2.Fshati Kuç – Buronja                             | Z.Aleks Baja      |
| 3.Kallarar.  | Z.Bashkim Davacaj |
| 4.Bolenë   | Z.Muhamet Alikaj  |
| 5.Vranisht   | Z. Bektash Basho  |
| 6.Tërbaç   | Z.Leandër Gjoka   |

### Njësia administrative Lukovë

- |                       |                   |
|-----------------------|-------------------|
| 1.Lukovë              | Z.Areteo Çetëri   |
| 2.Borsh               | Z. Ridvan Hajdini |
| 3.Fshati “Qazim Pali” | Z.Illirjan Ceka   |
| 4.Nivicë              | Z.Jani Munguli    |
| 5.Shën Vasil          | Z.Spiridhon Dusha |
| 6.Sasaj               | Z.Andi Ahmetaj    |
| 7.Fterrë              | Z.Profit Zani     |
| 8.Çorra               | Z.Mihal Duka      |
| 9.Piqerras            | Z.Florjan Hoxhaj  |

### Himarë - Qendër

- |           |                     |
|-----------|---------------------|
| 1.Qeparo  | Z.Themistokli Marta |
| 2.Kudhës  | Z.Agron Velço       |
| 3.Palas   | Z.Odhiseo Dhimoleo  |
| 4.Gjilekë | Z.Llambro Ruci      |
| 5.Vuno    | Z.Marko Çakalli     |
| 6.Ilias   | Z.Gogo Gjomemo      |
| 7.Pilur   | Z.Dritan Muço       |

-Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 29.01.2021 “Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashki.

KRYETAR  
Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5356/prot.

Himarë, më 21.11.2023

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E KRYESIVE DHE TË KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË BASHKINË HIMARË”**

Të nderuar këshilltarë,

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore neni 70 pika 1,2,3,4 dhe 5, neni 71,si dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak datë 22.09.2023 ,vendimi nr.41,vendimi nr.42,vendimi nr 43,vendimi nr 44,vendimi nr 45,gjatë muajt tetor 2023 u zhvilluan zgjedhjet për kryesitë e fshatrave e të kryetatëve të tyre në Bashkinë Himarë. Me përjashtim të fshatit Dhërmi procesi I cili nuk përfundoi në datën e caktuar nga këshilli.( Kryesia e këshillit vendosi të caktohet një tjetër datë sa më e afërt për zhvillimin e zgjedhjeve në këtë fshat)

Siç jeni në djeni fshati drejtohet nga kryesia e tij dhe kryetari i fshatit në bazë të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara në ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, e të Rregullores së Këshillit të Bashkisë.

Kryesia e fshatit u zgjodh në mbledhjen e fshatit dhe është organ këshillimorë i kryetarit të fshatit.

Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit u përcaktua në bazë të popullsisë së fshatit nga Këshilli Bashkiak .

Kryetari i fshatit u zgjodh nga kryesia e fshatit.

Puna dhe veprimtaria për zgjedhjen e kryesisë së fshatit në secilën prej njësive administrative u mbikqyr nga Këshilli I Bashkisë.

Për mbarëvajtjen dhe eficensën u procedua që kryesitë në fshatrat me më pak se 1000 banor u përbën me 3 anëtarë dhe në fshatrat me mbi 1000 banorë me 5 anëtarë.

Me miratimin e këtij projektvendimi nga ana e këtij këshilli për miratimin e kryesive të fshatrave proceduam që në këto pozicione të zgjidhen njerëz të aftë ,me profil të lartë kulturorë e profesional që gëzojnë respektin dhe kanë popullaritet në fshatrat e tyre ,për të vendosur standarte të larta,dinamike për të zgjidhur problemet që ka komuniteti.

Sikurse jeni në dijeni, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.50., date 30.10.2023 “Për miratimin e kryesive dhe të kryetarëve të fshatrave në Bashkinë Himarë” u miratua lista emërore e kryetarëve të fshatrave të Bashkisë Himarë.

Me shkresën nr.953/1 prot., datë 09.11.2023 me lëndë : “ Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Himarë.”, ky vendim është vlerësuar jo i ligjshëm nga ana e Prefektit të Qarkut Vlorë.

Bazuar në dispozitat ligjore të cituara nga Prefektit të Qarkut Vlorë, në arsyetimin e vendimarrjes së tij, nga ana e Sekretarit të Këshillit Bashkiak është realizuar plotësimi i dokumentacion dhe bazuar në nenit 16, pika 2, të ligjit nr.107/2016 “ Për prefektin e qarkut”, po jua paraqesim për rishqyrtim projektvendimin.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Elena Memushaj**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5356/prot.  
2

Himarë, më 21.11 .2023

**PROCESVERBAL**

**“PËR MIRATIMIN E KRYESIVE DHE TË KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË BASHKINË HIMARË”**

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore neni 70 pika 1,2,3,4 dhe 5, neni 71,si dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak datë 22.09.2023 ,vendimi nr.41,vendimi nr.42,vendimi nr 43,vendimi nr 44,vendimi nr 45,gjatë muajt tetor u mbajtën zgjedhjet për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave,në 22 fshatra të Bashkisë Himarë ( në fshatin Dhërmi ky proces nuk u zhvillua për mosdakortësim mes banorëve dhe komisionit për procedurën e zgjedhjeve).

Komisioni i votimit dhe i monitorimit të zgjedhjeve u përcaktua me vendim nga Këshilli Bashkiak,të cilët vetë këshilli do të ndiqte të gjitha procedurat në këto zgjedhje. Komisioni i votimit i përbërë nga një këshilltar i opozitës,një këshilltar i pozitës dhe një banor i lagjes apo fshatit për çdo qendër votimi,pati dhe fshatra ku banorët nuk dëshironin të kishin përfaqësues në komision. Po kështu edhe komisioni i monitorimit përfaqësohej nga një këshilltar i opozitës,një këshilltar i pozitës ,kryetari i këshillit,sekretar i këshillit bashkiak. Procesi zgjedhor u zhvillua me grupe fshatrash . Në datë 07.10.2023 deri më 22.10.2023 këshilli ishte në proces zgjedhor.

Në datë 07.10.2023 u mbajtën zgjedhjet në 5 lagjet e fshatit Vranisht ku anëtarë kryesie për çdo lagje u zgjodhën: 1.Bektash Basho ,2.Teki Kanani,3.Irakli Hasani,4.Aredin Shkurti,5.Bujar Zenelaj.

Të pestë anëtarët e kryesisë me votim të hapur votuan kryetarin e fshatit Vranisht Z.Bektash Basho.

Komisioni përbëhej nga këshilltari Timoleo Gërdhuqi,Dhimitër Kapaj,dhe banor I fshatit Memo Llanaj.

Ndiqte procedurën sekretarja e Këshillit .

Në datë 07.10.2023 u mbajtën zgjedhjet në fshatin Bolenë. Komisioni përbëhej nga Elisabeta Lamaj ,Miltiadh Prifti dhe Armando Malaj.Në tri lagjet e fshatit u zgjodhën me votim të hapur tre anëtarët e kryesisë .

Kryesia 1.Muhamet Alikaj,2.Polikron Bushaj,3.Muço Sadikaj. Kryesia me votim të hapur votoi kryetar fshati Bolenë Z.Muhamet Alikaj.

Në datë 07.10.2023 u mbajtën zgjedhjet në fshatin Kallarat. Anëtar komisioni ishin Gjergji Iliadhi ,Silva Burbo,Rajmonda Shakaj,anëtarët e kryesisë për tre lagjet e fshatit zgjodhën me votim të hapur kryetar fshati në Kallarat Z.Bashkim Davacaj.

Në datë 07.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Tërbaç me anëtar komisioni këshilltarët:Milto Nika,Thëllëza Kokaveshi dhe banor fshati Shkëlqim Hodaj. Në tre lagjet e fshatit u votua me votim të fshehtë në zgjedhjen e anëtarësisë dhe si përfundim të tre anëtarët e kryesisë: 1.Leandër Gjoka,2.Adriatik Mehmeti,3.Istref Rrokaj me shumicë votash (3) votuan kryetar të fshatit Tërbaç Z.Leandër Gjoka.

Më datë 07.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Kuç-qëndër me anëtar komisioni: këshilltarët Mirka Gjiçali ,Afrovita Dhimojani  
Në tri lagjet në fshatin Kuç- Qëndër dolën anëtar kryesie 1.Astrit Balilaj,2.Arjanit Toçi,3.Asllan Lalaj. Me shumicë votash zgjodhën kryetar fshati Z.Astrit Balilaj.

Më datë 07.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Kuç- buronja. Në të tria lagjet zgjodhën anëtarë kryesie 1.Aleks Bajaj,2.Andon Sadikaj,3.Diftir Ngucaj.  
Të tre anëtarët e kryesisë me shumicë votash zgjodhën kryetarin e fshatit Kuç-buronja Z.Aleks Bajaj.

Më datë 11.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në të 5-ta lagjet e fshatit Nivicë.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët:Dhimitër Kapaj ,Timoleo Gërdhuqi.  
Ndiqte procedurën sekretarja Elena Memushaj.  
Të pestë anëtarët e kryesisë 1.Jani Munguli,2.Niko Gjoni,3.Gentian Papagjika,4.Orest Dhimitrika ,5Miho Gjoni zgjodhën me votim të hapur kryetarin e fshatit Nivicë Z.Jani Munguli.

Më datë 13.10.2023 zhvillohen zgjedhjet në fshatin Sasaj ,me dëshirë të banorëve fshaçe,pasi propozuan 5 emra i hodhëm në votim .Votimi u bë i fshehtë.Nga numërimi dolën këto rezultate:

- 1.Andi Ahmetaj -22 vota
- 2.Franko Çela-14 vota
- 3.Nexhip Pula- 21 vota
- 4.Romeo Lelaj 21 vota
- 5.Ali Memi -18 vota.

Tre anëtarët që kanë shumicë votash zgjidhen anëtarë kryesie.  
Në kryesinë e fshatit zgjidhet: Andi Ahmetaj,Romeo Lelaj,Nexhip Pula.  
Këta anëtarë kryesie zgjodhën kryetar fshati Sasaj Z.Andi Ahmetaj.  
Komisioni përbëhej nga Këshilltarët,Dhimitër Kapaj,Timoleo Gërdhuqi.  
Sekretarja e Këshillit.

Më datë 09.10.2023 zhvillohen zgjedhjet në fshatin Lukovë . Komisioni përbëhej nga këshilltarët: Elisabeta Lamaj,Miltiadh Prifti,një banor I fshatit Vangjel Gjinomi  
Votimi u bë I mbyllur në çdo lagje.  
Anëtarit të fshatit u zgjodhën: 1.Areteo Çetëri,2.Vasil Gjosasi,3.Renato Vjeri,4.Albert Shehaj,Robison Gjinerari mungon në zgjedhjen e kryetarit.  
Katër anëtarët e kryesisë zgjodhën me votë të hapur kryetar fshati Lukovë Z.Areteo Çetëri.

Më datë 16.10.2023 zhvillohen zgjedhjet në fshatin Çorraj.  
Komisioni përbëhet nga këshilltarët: Milto Nika dhe Timoleo Gërdhuqi.  
Me propozim në qendër të fshatit zgjidhen anëtarët e kryesisë 1.Mihal Duka,2.Zaho Sotiri,3.Dhisevo Kopali.



Me votim nga anëtarësia zgjidhet kryetar fshati Z.Muhal Duka.

Më datë 18.10.2023 zhvillohen zgjedhjet në fshatin Kudhës.  
Në tre lagjet e fshatit propozojnë nga një anëtar kryesie.

- 1.Agron Velçi
- 2.Foto Leka
- 3.Spiro Tato.

Të tre anëtarët e kryesisë me votë të hapur votuan kryetarin fshati Kudhës Z.Agron Velçi.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët: Elisabeta Lamaj,Milto Nila dhe banor fshaçi Viktor Cani.

Më datë 18.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Qeparo.  
Votimi u bë fshaçe me dëshirë të banorëve. U propozuan 5 emra anëtarë kryesie.  
Kryesia me votim të hapur zgjodhi kryetarin e fshatit Qeparo me 5 vota pro, Z.Themistokli Marta.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët Dhimitër Kapaj dhe Timoleo Gërdhuqi.  
Ndoqi procedurën sekretarja e Këshillit.

Më datë 16.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Ftterrë.  
Në tre lagjet e fshatit u propozuan nga një anëtarë kryesie . 1.Arjanit Dhuli,2.Profit Zani,3.Flora Kurrupi.  
Nga votim të hapur kryesia zgjodhi kryetar fshati Ftterrë ,Z.Profit Zani.  
Komisioni u përbë nga këshilltarët : Milto Nika,Timoleo Gërdhuqi .

Më datë 21.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Borsh.  
Në të 5 lagjet e fshatit Borsh Votimi u bë i fshehtë dhe anëtar kryesie dolën ,1.Artan Shehaj,2.Illirjan Lala,3.Olgert Xhuveli,4.Ridvan Hajdini,5.Vullnet Çika.  
Të pestë anëtarët e kryesisë me votim të hapur votuan kryetar fshati Borsh Z. Ridvan Hajdini.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët : Fuat MATI,Nertila Husi  
Në procesin zgjedhor ishte dhe sekretarja e Këshillit.

Më datë 15.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Piqeras.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët : Mirka Gjiçali dhe Afrovita Dhimojani.  
Në pesë lagjet e fshatit Piqeras dolën anëtarët e kryesisë me votë të fshehtë.  
1.Kiço Çuni,2.Mihal Memi,3.Lluk Nika,4.Misto Luska,5.Florjan Hoxha.  
Kryesia votoi kryetar fshati Piqeras Z. Florjan Hoxha.

Më datë 09.10.2023 u zhvillua zgjedhjet në fshatin Shën Vasil.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët: Afrovita Dhimojani dhe Milto Nika.  
Në 4 lagjet e fshatit u zgjodh me votim të mbyllur Kryesia.  
Anëtar kryesie dolën: 1.Margarit Vogli,2.Spiridhon Dhusha,3.Minella Balla,4.Ferdinand Mëkshi.  
Në lagjen “ Pulltet” nuk u zhvilluan zgjedhjet pasi pati konstatime nga banorët me komisionin.  
Katër anëtarët e kryesisë I njohën zgjedhjet dhe zgjodhën me shumicë votash kryetarin e fshatit Shën Vasil Z .Spiridhon Dusha.

Më datë 14 .10 .2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Pilur.  
Komisioni përbëhej nga këshilltarët : Dhimitër Kapaj,Timoleo Gërdhuqi.  
Ndiqte procedurën sekretarja e Këshillit.  
Monitorues ishin këshilltarët: Elisabeta Lamaj dhe Afrovita Dhimojani.  
Votimi u bë fshaçe dhe me votë të mbyllur

---

Fshati ishte unanim dhe na propozuan 6 emra për kandidim. Të 6 emrat u hodhën në votim . Nga numërimi i 6 anëtarëve të votuar dolën këto rezultate.

- 1.Dritan BALA- 66 vota
- 2.Artan Boçi – 60 vota
- 3.Marko Bala- 68 vota
- 4.Dritan Muço- 88 vota
5. Nikolla Gërdhuqi- 99 vota
- 6.Thanas Mërkuri- 88 vvota.

Tre anëtarët që kanë më shumicë votash zgjidhën anëtarë kryesie:Dritan Muço,Nikolla Gërdhuqi,Thanas Mërkuri. Këta të tre zgjedhin kryetarin e fshatit Pilur Z. Dritan Muço. Në fund të procesit të 6 kandidatët firmosën procesverbalin përfundimtar . Nga Kryetari aktual i fshatit dhe anëtarët e kryesisë që kandidonin pati diskutime disa banorë të Pilurit me pretendimin nga të dyja palët se nuk janë me gjendje civile në Himarë. Komisioni mori shënim emrat për verifikim për personat që votuan dhe procedura vazhdoi e qetë deri në përfundim. Kryesia e këshillit pasi bëri verifikimet dhe shqyrtoi materialin e zgjedhjeve në fshatin Pilur rezultoi se banorët që votuan ishte me gjendje civile në Himarë .

Më datë 19.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Palasë.

Komisioni u përbë nga këshilltarët: Timoleo Gërdhuqi dhe Mirka Gjiçali.

Në tre lagjet e fshatit u procedua me votim të hapur. Anëtarë kryesie dolën:1.Odhiseo Dhimoleo,2.Dhimosten Kokuri,3.Leonard Çeço.

Me votim unanim zgjidhet kryetar I fshatit Palasë ,z.Odhisa Dhimoleo.

Më datë 21.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Ilias.

Komisioni përbëhej nga këshilltarët:Timoleo Gërdhuqi dhe Artan Bala.Me votim të hapur

dhe në unanime në tre lagjet e fshatit Palasë u zgjodh kryesia,1.Gogo Gjomeno,2 .Artur Bala,3.Andrea Marku.

Kryesia zgjodhi kryetarin e fshatit Ilias Z.Gogo Gjomeno.

Më datë 20.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet më fshatin Gjilekë.

Komisioni përbëhej nga këshilltarët:Thodhori FOTO dhe Timoleo Gërdhuqi.

Në 5 lagjet e fshatit u procedua me votim të hapur dhe u zgjodhën anëtarët e kryesisë,1.Llambro Kleanthi Ruci,2.Spiro Jako Malo,3.Vangjel Koço Ruci,4.Evgjenia Jorgo Meksi,5.Zaharulla Petro Bifsha.

Me votë të pestë anëtarët e kryesisë zgjodhën për kryetar fshati Gjilekë Z .Llambro Kleanth Ruci.

Më datë 21 .10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Vuno.

Komisioni përbëhej nga këshilltarët:Timoleo Gërdhuqi dhe Artan Bala.

Në fshatin Vuno me votim të fshehtë u zgjodhën tre anëtarë kryesie.

- 1.Marko Çakalli
- 2.Alferd Halilaj
- 3Pilo Paço.

Me votim dhe me rezultatin dy me një u zgjodh kryetar fshati Vuno Z. Marko Çakalli.

Më datë 13.10.2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatin Qazim Pali.

Komisioni u përbë nga këshilltarët : Elisabeta Lamaj dhe Timoleo Gërdhuqi.

Mbas përfundimit të zgjedhjeve në fshatin Qazim -Pali dolën këta anëtarë për kryesinë e fshatit. Nga lagjja e fermës dolën 4 anëtarë dhe një anëtarë nga lagjja e shkallës

1 Ilirjan Ceka,2.Kosta Veizi,3.Arjo. Hysi,4.Virjon Rapi ,5.Ndrec Paloka.

Të pestë anëtarët e kryesisë së fshatit zgjodhën kryetar fshati për Qazim Palin Z Ilirjan Ceka.



Në fshatin Qazim Pal pati një mosdakortësi mes banorëve të cilët u ndanë në dy grupe dhe njëri grup nuk ju bashkua komisionit që kishte deleguar këshilli për zgjedhjet. Megjithë përpjekjet që bën komisioni, kryetari këshillit, sekretari këshillit për t'u bashkuar si banorë pranë komisionit nuk rezultoi, ndërkohë komisioni kishte nisë procedurën me banorët dhe e përfundoi me aq sa banorë morën pjesë .

Ankesa drejtuar këshillit Bashkiak për procesin zgjedhor të kryetarëve të fshatrave na kanë ardhur nga Kryetari aktual I fshatit Vuno, nga Kryetari aktual I fshatit Pilur, nga Kryetari aktual I fshatit Qazim -Pali. Sekretarja e Këshillit I ka paraqit të gjitha ankesat kryetarit të këshillit ,I cili i ka shqyrtuar të gjitha një për një në mbledhjen e këshillit të muajt tetor, të gjithë këshilltarët komisioner që kanë marr pjesë në procesin zgjedhor kanë bërë shpjegimet e tyre . Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar në këshill dhe këshilli vendosi miratimin e procesit zgjedhor me shumicë votash.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!



**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Elena Memushaj**